

DECORFILM

SHTRESË MBROJTËSE ME BAZË UJI PËR DEKORIME DHE LYERJE NË SIPËRFAQE TË BRENDSHME DHE TË JASHTME

Kodi 3740238/230

PËRSHKRIMI

Decorfilm është llak transparent me bazë uji që ofron mbrojtje për sipërfaqet e brendshme dhe të jashtme të trajtuara me bojë dekorative, bojra me bazë uji dhe llaqe. Formula uretane akrilike e modifikuar krijon një shtresë të pastër mbrojtëse që ka rezistencë mekanike të shkëlqyer. Në mure të lyer me bojra me bazë uji, aplikimi i Decorfilm zvogëlon fenomenin e ndryshimit të ngjyrës, rrit rezistencën ndaj larjes me ujë. Tharje e shpejtë dhe jo-zverdhje, Decorfilm ka mbulim dhe adezion, rezistence të shkëlqyer. E disponueshme në të dy versionet, Mat dhe me shkëlqim (Lucido), të miksueshme në mënyrë perfekte me njëra-tjetrën. Kështu që mund të keni nivele të ndryshme shkëlqimi të përshtatshme për sfondin e sipërfaqes që doni të mbroni. Është në përputhje me kërkesat e higjienës Reg.EC 852/2004.

ISTRUKSIONE PËR PËRDORIM

Mund të aplikohet në:

- Sipërfaqe dekorative organike
- Sipërfaqe dekorative minerale vetëm Brenda: Aplikoni Decorfilm Opaco (matt) dhe Decorfilm Lucido (me shkëlqim), të miksuara së bashku 1:1. Vetëm mbi Grassello Di Calce përbën përjashtim:
- nëqoftëse përdoret, duhet të përdorni vetëm Decorfilm Lucido (me shkëlqim).
- Bojra me bazë uji dhe bojra me ndikime të ndryshme estetike.
- Bojra të vjetra dhe organike,minerale, të thara, kompakte, thithëse dhe shtresa kohezive.
- Caktoni Decorfilm që i përshtatet më shumë llojit të produktit që doni të mbroni. Decorfilm Opaco (me kod 3740238) është e rekomanduar për sipërfaqe satine-të sheshta, ndërsa Decorfilm Lucido (me kod 3740230) përdoret përgjithësisht për sipërfaqe shkëlqyese. Versioni shkëlqyës mbi sipërfaqen mat alternohet në fund.

- Decorfilm ka rezistencë të mirë ndaj detergjentëve normalë shtëpiakë. Rekomandohet një test pastrimi paraprak në një zonë të vogël të fshehur të substratit (siperfaqes) në mënyrë që të testohet rezistenca.
- Shmangni përdorimin e alkoolit etilik të denaturuar,si në formën e pastër ashtu edhe në detergjentë.
- Mos përdorni sfungjerë gërryes për të pastruar sipërfaqet.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

- Natyra e Kordonit: Akrilik i modifikuar me rrëshirë urethane në dispersion ujor.
- Graviteti Specifik për UNI EN ISO 2811-1: 1.00 ± 0.05 kg/l
- Viskoziteti për UNI 8902: 1000 ± 200 cps at 25 °C
- Shkëlqimi për UNI EN ISO 2813: DECORFILM LUCIDO (3740230): >80 këndi i leximit 60° DECORFILM OPACO (3740238): 5±2 këndi i leximit 85° LUCIDO/OPACO përzierje 1:1 rreze: 10±2 këndi i leximit 60° LUCIDO/OPACO përzierje 2:1 rreze: 20±2 këndi i leximit 60°
- Koha e tharjes (në 25 C dhe 65% R.H): pa pluhur për 1 orë; kontakt për 2-3 orë; shtresa tjetër pas 4 orësh
- HACCP plotëson rregullat (kërkesat) e Reg. EC 852/2004
- *Raporti i testit N.232F2017 Studio ASA - Treviso, sipas standardeve UNI 11021: 2002.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

- Sipërfaqet e murit:
- Aplikoni Decorfilm mbi sipërfaqe me efekte dekorative, bojra ose llaqe që janë kompakte, të thara dhe pa mospërputhje (incoerenze).

DECORFILM

SHTRESË MBROJTËSE ME BAZË UJI PËR DEKORIME DHE LYERJE NË SIPËRFAQE TË BRENDSHME DHE TË JASHTME

Kodi 3740238/230

INSTRUKSIONET E APLIKIMIT

- Kushtet e ambientit dhe të sipërfaqes së materialit:
- Temperatura e ambientit: Min. +8 °C / Max. +35 °C
- Lagështira relative e ambientit: <75%
- Temperatura e sipërfaqes së materialit: Min. +5 °C / Max. +35 °C
- Niveli I lagështirës së sipërfaqes së materialit: <10%
- Mjetet: Furcë, rrul, spraj,tampone sfungjeri
- Nr. I shtresave: 1-2
- Hollimi: ujë
- Hollimi: Varion në varësi të absorbimit dhe mjeteve të përdorura. Normalisht shtresën e parë dhe të dytë hollojeni 5-15%. Për sipërfaqe shumë absorbuese, shtresën e parë hollojeni 25-30%.
- Pastroni mjetet me ujë menjëherë pas përdorimit.
- Shkalla e mbulimit afërsisht: Varet nga natyra e produktit që do lyhet. 10-12 m²/l për shtresë për sipërfaqe të buta mesatarisht absorbuese.

NGJYRIMI

Llaku është pa ngjyrë në versionin bazë me kod 3740238 dhe me shkëlqim me kod 3740230.

MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e magazinimit: +30°C
Temperatura minimale e magazinimit: +5°C
Produkti duhet të përdoret brenda 2 vjetësh nga data e prodhimit kur ruhet në ambalazhe të pahapur dhe në kushte të përshtatshme temperature.

TE DHENA MBI SIGURINE

Vlera limite BE (Dir. 2004/42/EC)
Kat. A/l: Bojë Dekorative (bazë-ujë): 200 g/l (2010)
DECORFILM përmban max: 100 g/l VOC
Përdoreni produktin në bazë të standardeve aktuale të higjienës dhe sigurisë, pas

përdorimit, mos I hidhni ambalazhet, lërinë të thahen dhe I trajtoni si mbetje të vecanta.
Mos I hidhni mbetjet në kanalizime,korsitë e ujit ose në terren
Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e të dhënave të sigurisë.

SPECIFIKIMET

Llak me bazë rrëshirë akrilike e modifikuar me urethane që ofron mbrojtje për sipërfaqe të brendshme dhe të jashtme në dispersion ujqor. Specifike për sipërfaqe që më parë janë trajtuar me bojra organike dekorative, shtresa të brendshme minerale, bojra me bazë uji dhe llaqe, Decorfilm është I disponueshëm në versionin Mat me kod 3740238 dhe shkëlqim me kod 3740230 në bazë të rezultatit estetik të dëshiruar.
DECORFILM aplikohet në 1-2 shtresa, në varësi të rezultatit estetik të dëshiruara. Sasia e kërkuar varet nga absorbimi I sipërfaqes.
Furnizimi dhe instalimi i materialit € për m².

SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperiencia e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti I produktit. Skeda e paraqitur anullon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike +39 041 4569322.